



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.Shk II.nr. 1654/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Departamenti i Përgjithshëm, Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtarin Faton Bajrami në çështjen përmbartimore të kreditorit Byroja Kosovare e Sigurimit me seli në Prishtinë, rr. “Magjistralja Prishtinë-Fushë Kosovë, p.nr, kundër debitorit Kompania e Sigurimeve Kosova e Re Sh.a me nr. unik identifikues 810486135, me seli në Prishtinë, adresa lagja Kalabria – Blloku B1, nr.5, me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës Dhomat e Shkallës së parë, KPPP.nr.923/22 të datës 25.09.2023, me datë 01.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e kreditorit Byroja Kosovare e Sigurimit me seli në Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës Dhomat e Shkallës së parë, KPPP.nr. KPPP.nr.923/22 të datës 25.09.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale Dhomat e Shkallës së parë, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr. KPPP.nr.923/22 të datës 25.09.2023, Ndërpritet procedura në çështjen përmbartimore në mes të kreditorit Byroja Kosovare e Sigurimit kundër debitorit Kompania e Sigurimeve “Kosova e Re” SH.A., e lejuar sipas Urdhrit Përmbartimor P.nr. 656/21 të datës 12.05.2021 të Përmbartuesit Privat Valdrin Beka, për shkak të fillimit të likuidimit të detyrueshëm ndaj debitorit.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë kreditori, për shkak të shkeljeve të dispozitave të ligjit për procedurën përmbartimore, dhe zbatimit të gabuar dhe jo të plote të se drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Shkallës së Dytë, të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të anulohet aktvendimi i Komerciale Dhomat e Shkallës së parë, KPPP.nr.2092/22 të datës 29.06.2023, dhe lënda të kthehet në rivendosje.

Debitori nuk ka ushtruar përgjigje në ankesë.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

- Ankesa e kreditorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori Byroja Kosovare e Sigurimit, ka paraqitur propozim për përbarim P.nr. 656/21 të datës 12.05.2021, me të cilin ka lejuar përbarimin, në bazë të dokumentit të besueshëm: Fatura nr.1-4/20 e datës 05.10.2020, Fatura TM-2/21 e datës 06.04.2021, Fatura FKSH 1-1/21 e datës 03.03.202, Fatura 1-1/21 e datës 05.01.2021, me të cilin është urdhëruar debitori KS Kosova e Re, që në afat prej 7 ditësh t'ia paguaj kreditorit shumën e përgjithshme në vlerë prej 341,187.00 EUR, në emër të borxhit kryesor dhe shpenzimeve të procedurës përbarimore për aq sa do të krijohen

Lënda në fjalë, është regjistruar me shenjë PPP.nr. 813/2021 në Gjykatën Themelore në Prishtinë për vendosje sipas propësimit të debitorit, ndërsa pas hyrjes në fuqi të Ligjit për Gjykatën Komerciale, në bazë të kompetencës lëndore është transferuar për shqyrtim në Gjykatën Komerciale dhe ka marrë numrin KPPP.nr. 923/22.

Gjykata Komerciale –Dhoma e Shkallës së Parë, lidhur me këtë çështje juridike përbarimore është informuar zyrtarisht që debitori KS “Kosova e Re” i është nënshtruar procedurës së likuidimit të detyrueshëm dhe atë sipas vendimit nr. 70-24/2021, të datës 24.09.2021 të lëshuar nga Banka Qendrore të Kosovës.

Andaj në lidhje me këtë, sipas nenit 17 të Ligjit për Procedurën Përbarimore përcaktohet se “Në procedurën përbarimore përshtatshmërisht zbatohen dispozitat e Ligjit për Procedurën kontestimore, po qe se me këtë ligj ose me ndonjë ligj tjetër nuk parashihet diçka tjetër”, ndërsa me nenin nenit 277, par.1, d) të LPK-së të me të cilën përcaktohet se “ Procesi gjyqësor ndërpritet: d) kur paraqitet propozimi për fillimin e procedurës së falimentimit në kontestet në të cilat i padituri është debitor falimentues”. Meqenëse debitori KS Kosova e Re i është nënshtruar likuidimit të detyrueshëm sipas vendimit nr. 70-24/2021, të datës 24.09.2021 të lëshuar nga ana e BQK-së,

Tutje Gjykata e shkallës së parë vlerëson se procedura në këtë çështje përbarimore në kuptim të nenit 277, pika (d) duhet të ndërpritet, kjo për faktin se duke qenë në procedurë të likuidimit, debitori tanimë ka marrë cilësinë e debitorit falimentues.

Gjykata Komerciale - Dhomat e Shkallës së Dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata Komerciale - Dhomat e Shkallës së dytë, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata Komerciale – dhomat e shkallës së dytë pas shikimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës si dhe ankesës se parashtruar ka vlerësuar se gjykata e shkallës së parë ka vendosur drejt kur e ka ndërprerë procedure ne këtë çështje përmbarimore, meqenëse debitori KS Kosova e Re i është nënshtruar likuidimit të detyrueshëm sipas vendimit nr. 70-24/2021, të datës 24.09.2021 të lëshuar nga ana e BQK-së, dhe në kuptim të nenit 277, pika (d) kjo procedurë duhet të ndërpritet

Tutje dhoma e shkallës së dytë vlerëson se nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të kreditorit se ligji në të cilin është bazuar gjykata nuk është i zbatueshëm ndaj kompanive te sigurimit dhe ndërmjetëseve te sigurimeve, e te cilat rregullohen me ligj të veçantë, mirëpo të njëjtat gjykata i gjeti si të pabazuar. Nga të cekurat me lartë kjo gjykatë vlerësoj se aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë duhet vërtetuar dhe të refuzohet ankesa e kreditorit.

Andaj, konform nenit 17 të LPP-së, në lidhje me nenin 277, pika (d) dhe 280, par.1 e LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhoma e shkallës së dytë

K. DH.Shk II.nr. 1654/23 me datë 01.03.2024

**Gjyqtari,
Faton Bajrami**